



### P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **16.02.2022**, me fillim në ora **10.00**. Mbledhjen e kryesoit kryesuesi i Kuvendit **Defrim Kafexhiu**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes nënkyetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtoret e drejtive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

### R E N D D I T E

- 1. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit komunal te aksionarëve nga Komuna e Rahovecit për Ndërmarrjen Publike Lokale “ KRM Ekoregjioni”ne Rahovec;**
- 2. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit komunal te aksionareve nga Komuna e Rahovecit për Ndërmarrjen Publike Lokale “ Stacioni i Autobusëve” ne Rahovec;**
- 3. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e komisionit për përgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës se institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese para universitare ( IEAAP);**
- 4. Shqyrtimi i Propozim vendimit për themelin e Këshillit te fshatit Hoçë e Madhe;**
- 5. Shqyrtimi i Propozim vendimit për miratimin e vendimit për formimin e komisionit për vlerësimin e performances së kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme komunale;**
- 6. Shqyrtimi i vendimit për shpalljen me interes te përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-01472-3 në zonën kadastrale ne Rahovec;**
- 7. Shqyrtimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes te përgjithshëm publik P-71510057-01997-11 në zonën kadastrale ne Rahovec;**
- 8. Shqyrtimi i vendimit për bartjen e mjeteve vetanake te pashpenuara nga viti 2021 ne vitin 2022;**
- 9. Shqyrtimi i Propozim vendimit për mbulimin e shpenzimeve te varrimit për vitin 2022;**
- 10. Shqyrtimi i Propozim vendimit për subvencionimin e lindjeve për gratë-nënët banore te Komunës se Rahovecit për vitin 2022;**

- 11. Shqyrtimi i vendimit për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës ne terrene për zgjedhjen e këshillave lokalë;**
- 12. Shqyrtimi i vendimit për emërimin e komisionit të ankesave për procesin e zgjedhjes se këshillave lokalë;**
- 13. Raporti nga Komiteti për Komunitete për vitin 2021;**
- 14. Të ndryshme.**

**Kryesuesi**-Para se me fillua me diskutimin rreth pikave te rendit te ditës, unë kam një propozim për ju pasi rendi i ditës ka shume përbajtje dhe kisha kërkuar që disa pika të largohen dhe të lihen për seancën tjetër me qëllim që seancat te janë sa më produktive dhe Kuvendi Komunal me shtjerrë debatin në mënyrën më të mirë të mundshme për secilën pikë të rendit të ditës dhe me qenë më përbajtësor dhe sigurisht se seancat me zgjat më pak që mos të kenë edhe ngarkesë për kuvendarët duke shqyrtaur dhe duke marrë vendime. Meqenëse për seancën e radhës shumica e pikave kanë votim dhe gjithashtu edhe për formimin e komisioneve te ndryshëm. Kështu që nëse i keni pikat e rendit te ditës para jush, propozoj që pika 3, 6, 7, 11 dhe 12 te shtyhen për seancën tjetër.

**Besa Bytyqi** – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkyetar, drejtore të drejtorive, kolegë asamblistë. Si grup i Aleancës për Ardhmérinë e Kosovës konsiderojmë që kemi kohën e mjaftueshme për t'i debatuar dhe shterrur debatin për të gjitha këto pika dhe nuk është e thëne se çdo seancë te përfundoj brenda dy ore dhe unë besoj që edhe ne seancën tjetër kemi edhe hapësirë kohore për të diskutuar secilën pikë të rendit të ditës dhe une pajtohem që të vazhdoj me këto pika të rendit te ditës.

**Bejtullah Deliu** – Përvendetje i nderuar kryesues, nënkyetar, drejtore të drejtorive, kolegë asamblistë. Ndoshta janë edhe pak si tepër të gjitha këto pika për një seancë por nëse kemi një gjuhë të përbashkët dhe pajtohemi mundeni që disa pika me i lanë për mbledhjen e radhës.

**Faton Ramadani** - Përvendetje kryesues, nënkyetar, drejtore të drejtorive dhe ju anëtar të KPF-së. Pra para vetes e kam rendin e ditës që i keni propozua dhe i keni nënshkruar vet këtë rend ditë dhe ne konsiderojmë që ky është rendi i ditës për sot dhe mendoj se është kohë e mjaftueshme për diskutim për sot dhe jemi te zgjedhur për me i diskutua dhe me i kalua këto pika pasi për muajin tjetër sigurisht se vijnë pika tjera që ndoshta edhe mund te ketë edhe me shume pikave për muajin tjetër, nuk kemi garanci për ketë se se a do të kemi më pak apo më shumë.

**Kryesuesi** – Sikur që nuk e kam ditë që janë këto pika të rendit të ditës, pasi këto kanë ardhur të gatshme prej sekretarisë së kuvendit nga drejtoret që i kanë propozua pikat e rendit të ditës, sigurisht se janë te nënshkruara nga unë, por, Komiteti për Politikë dhe Financa i paraprinë seancave të kuvendit dhe unë vetëm pyeta nëse hasim në mirëkuptim që me i filtruat këto pika te rendit te ditës apo edhe disa me i shtyje për seancën tjetër.

**Besa Bytyqi** – Konsideroj se secila shtyrje e secilës pikë te rendit te ditës është ne dëm të legjislativit ekzekutivit dhe qytetarëve të komunës së Rahovecit, pasi që drejtoret me ekzekutivin se bashku me kryetarin dhe nënkyetarin që e kanë sjellë secilën pikë e dinë me së miri rëndësinë që e kanë sjellë pikërisht ne këtë seancë d.m.th. ne nuk jemi këtu për me i shtyje proceset por me i qua proceset përpëra dhe po besoj që kemi me hasë ne mirëkuptim dhe me vazhdua me këtë rend te ditës ashtu siç e kemi.

**Fatmir Iska** – Faleminderit kryesues, anëtarë te KPF-së, drejtore të drejtorive dhe gjithë ju te pranishëm. Rendin e ditës e bën kryesuesi bashke me kryetarin e komunës dhe ju prezantojnë anëtarëve te kuvendit. Ekziston një plan i punës se kuvendit që i përcakton pikat e rendit te ditës dhe pavarësisht që kjo legislaturë ka anëtarë të rinj të zgjedhur dhe nuk kanë bërë këtë plan të punës së kuvendit por anëtarët e kuvendit të kaluar e kanë bërë planin e punës se kuvendit për vitin 2022 dhe ne duhet me zbatua këtë plan. Pastaj janë disa pika që kërkojnë urgjencë si p.sh. tek pika 3 shqyrtimi i vendimit për caktimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorit sigurisht se patjetër duhet me qenë pike e rendit te ditës dhe kryesisht këto formime te

komisioneve nuk kërkojnë kohë pasi vetëm partitë politike dakordohen për emra dhe vazhdohet tutje. Pra kjo duhet me qenë patjetër pikë e rendit te ditës. Pastaj tek pika e 6-të është shqyrtimi i vendimit për shpalljen me interes te përgjithshëm publik, pra fjala është për çerdhen që do te financohet nga qeveria dhe se cilën ditë që ne vonohemi do te jetë me keq për arsyen se duhet te ndahet parcela pastaj duhet te shpallet interes i përgjithshëm pastaj te kaloj ligjshmëria ne MAPL pastaj te shqyrtohet ligjshmëria pastaj ti kthehet komunës te bëhet projekti te shpallet procedura ndërsa ne nëse brenda vitit kalendarik nëse nuk e shpallim procedurën deri ne korrik apo gusht atëherë kjo dështon dhe për këtë duhet te jemi te vetëdijshëm. Pastaj nëse kërkoni edhe shtyrjen e pikës se 11-të, atëherë automatikisht u deshtë me u konsultua edhe me kërkua edhe shtyrjen e pikës se 12-të, kështu që te gjitha këto janë pa arsyen dhe meqenëse janë formime te komisioneve atëherë them që meqenëse jeni edhe ju propozues te rendit te ditës them që me vazhdua këtë punë me këtë rend dite pasi detyra e anëtarëve te KPF-së dhe anëtarëve te kuvendit komunal është me u lodhe edhe legjislativi edhe ekzekutivi. Kështu që këto pika te rendit te ditës disa kërkojnë urgjencë kurse te tjerat janë krejt ne rregull dhe ka pasur raste kur kemi pasur edhe me 17 pika te rendit te ditës dhe kanë kaluar por sigurisht se duhet punë dhe angazhim nga te gjithë ne.

Kryesuesi – Faleminderit nënkyetar, e qesim ne votim rendin e ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë ne pikën e parë te rendit te ditës:

**1. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit komunal te aksionareve nga Komuna e Rahovecit për Ndërmarrjen Publike Lokale “ KRM Ekoregjioni “ ne Rahovec.**

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, te nderuar anëtar te Komitetit për Politike dhe Financa, te nderuar kolegë drejtor dhe gjithë ju te pranishëm. Unë kam propozimin për dy komisione që ne fakt edhe i takojnë departamentit për shërbime publike që është komisioni për themelimin e ndërmarrjes lokale Stacioni i Autobusëve dhe ndërmarrjes publike KRM EkoRegioni, që realisht Stacioni i Autobusëve është 100% aset i komunë se Rahovecit kurse KRM Ekoregjioni është pjesë e aksionareve me përqindjen e caktuar që kemi aty. Pra janë dy komisione që janë obligative sipas ligjit për ndërmarrje publike dhe këto janë veç propozimet që kanë me dal prej kuvendit te komunës pra dy anëtar ndërsa një anëtar do te jetë nga ekzekutivi. Kështu që unë nuk do te zgjatesha me shume që me shpjegua edhe ligjin pasi është e specifikuar edhe ne vendim, kështu që kërkoi nga Komiteti për Politike dhe Financa që ti kaloj këto pika për mbledhje te kuvendit dhe ti zgjedhim anëtaret e rinjë dhe njehërit kërkoi për të dy pikat që me përshtypja këtë.

Besa Bytyqi – Unë mund te them se tanë vetëm duhet që të votojmë që këto dy pikat te kalon për mbledhje te kuvendit.

Kryesuesi – E qesim ne votim pikën e parë te rendit te ditës. Konstatoj se me shumicë te votave kalon për kuvend pikë e pare e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e dytë te rendit te ditës:

**2. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionareve nga Komuna e Rahovecit për ndërmarrjen publike lokale” Stacioni I Autobuseve”në Rahovec.**

Pasi është njëjtë proceduralisht sikur pika e pare, e qesim ne votim. Konstatoj se unanimisht kalon pikë e dytë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e tretë te rendit të ditës:

**3. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe te zëvendëdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese para universitarë (IEAAP)**

Fatmir Iska – Në mungesë te drejtorit te Arsimit, është një komision që është obligativ dhe sigurisht se emrat janë veçse ne këto komisione përfaqësuesi i MASHT-it varet nga ministria se kënd do te delegoj me emër d.m.th. dy anëtar i kemi te precizuar me emër kurse emri i trete delegohet nga ministria që mund te jetë në një komision dhe ne komisione tjera mund te ndërrohet dhe për këtë arsyen e kemi evidentua si përfaqësuesi i MASHT-it sipas udhëzimit administrativ, kështu që diçka tjetër nuk kam me shtua pasi këtu kemi edhe arsyetimin.

Kryesuesi – Faleminderit nënkyetar, këtu vetëm kisha shtua se një anëtar është prej MASHT-it kurse dy anëtarë i propozon drejtoria e arsimit. Kështu që edhe këtë pikë te rendit te ditës e qesim ne votim. Konstatoj se unanimisht kalon për kuvend. Kalojmë ne pikën e katërt te rendit te ditës;

**4. Shqyrtimi i propozim vendimit për themelimin e Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe.**

**Fatmir Iska** – Propozimi për themelimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe por këtu duhet me sqarua sepse kjo themelohet sipas ligjit pasi ekzistojnë dy këshilla lokalë kurse ky këshill është i themeluar me ligje. Ky këshill formohet prej kuvendit dhe mandati pushon me përfundimin e mandatit te kuvendit. Kështu që se pari tash ne duhet me marr vendim për themelim pastaj do te behet thirrja publike për aplikim pastaj do te vjen prape ne kuvend për themelimin e një komisioni për përzgjedhjen e atyre aplikacioneve dhe krejt ne fund ne një seancë tjetër do te sjellët vendimi me emra për themelim e këshillit te fshatit. Përbërja e këshillit është 5 anëtar, ku 2 anëtar janë nga komuniteti serb, 1 anëtar është i deleguar prej kishës ortodokse serbe dhe 2 anëtar janë nga shumica. Pastaj varësisht nga aplikacionet që do të sjellin aplikantët, atëherë komisioni do te bën përzgjedhjen dhe do t'i propozoj kuvendit dhe për zgjedhjen e tyre varet nga vullneti i kuvendareve.

**Kryesuesi** – Meqë nuk kemi te lajmëruar sa i përket pikës se katërt, e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht kalon per kuvend pika e katërt e rendit te ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit te ditës:

**5. Shqyrtimi i Propozim vendimit për miratimin e vendimit për formimin e komisionit për vlerësimin e përformancës së kontratës për dhënien ne shfrytëzim të pronës se paluajtshme komunale.**

**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkyetar, kolegë drejtor, anëtar te KPF-së dhe gjithë ju te pranishëm. Në mbështetje te ligjit për vetëqeverisje lokale, kryetari i Komunës i propozon komitetit për Politikë dhe Financa për formimin e komisionit për vlerësimin e performancës se kontratës për dhënien në shfrytëzim te pronës se paluajtshme komunale. Këtu behet fjalë për kontratën që e ka ne shfrytëzim SHL-Kosova ne rrugës Gzim Hamza-Piktori që kontrata i ka skaduar dhe tash po kërkojmë nga ju që kete pikë me përbërje prej 5 anëtareve ku 3 anëtar i takojnë kuvendit te komunës kurse 2 anëtar tjer ne koordinim me kryetarin e komunës vendoset ne kuvend për 5 anëtaret. Detyrat dhe obligimet e komisionit janë te përshkruara dhe ne seancën e kuvendit këtë pikë do ta keni te kompletuar edhe ne dokumente tjera përcjellëse sipas kërkesës që gjithashtu do ta keni te prezantuar edhe ne projektor. E kemi bërë praktikë që për mbledhje te KPF-së mos me ju ngarkua me materiale mirëpo me materiale tjera shtesë si ortofoto certifikate te pronës pasi behet fjalë për një kontratë që është pronë e komunës ku e ka te ndërtuar objektin qendra rimore SHL-Kosova që e ka pasur ne shfrytëzim për kohe te caktuar dhe i ka skadue kontrata dhe prape i kthehet e drejta kuvendit me formua komisionin dhe me vendos prape se për sa vite me dhanë ne shfrytëzim. Keshtu që ftojë anëtaret e KPF-së që te votojnë për këtë pikë që te kaloj për kuvend.

**Bejtullah Deliu** – Përshëndetje kryesues, drejtor i nderuar ndoshta kjo praktikë për sjelljen e dokumenteve të tepërtë për mbledhje të KPF-së, por, sigurisht se duhet të sillen pasi kemi nevojë të informohemi paraprakisht para seancës që të kemi mundësi të shtjellojmë dhe të shqyrtojmë më shumë, e sigurisht që të dimë që për çka do të votojmë.

**Besë Bytyqi** – E falënderojmë drejtorin Oruqi për sjelljen e materialit dhe gjithashtu e presim që edhe ne seancën e kuvendit me pas materialin shtesë. Ne që kemi qenë edhe ne mandatin e kaluar e dimë që i kemi diskutuar gjerat në seancën e rregullt të kuvendit dhe ky propozim është vetëm për të kaluar ne seancën e rregullt të kuvendit dhe nuk kemi të propozojmë emra apo diçka tjetër por vetëm që të kaloj për mbledhje te kuvendit në procedura të rregullta.

**Bejtullah Deliu** – E di që do të shqyrtohen shumë pika në seancë dhe do të analizohen ato mirëpo do të ishte keq që me pas material më tepër edhe për mbledhje te KPF-së, kështu që nuk e shoh shumë të arsyeshme përgjigjen që e dha drejtori me herët.

**Fatmir Iska** – me shume te drejtë e ka z. Deliu, pavarësisht se a është KPF apo mbledhje e Kuvendit, vetëm nëse servohen me vonesë materialet mund te këtë mungesë përndryshe secili material që i dërgohet anëtareve te KPF-së por edhe anëtareve te kuvendit për mbledhje te kuvendit duhet me qenë material i plotë.

**Kryesuesi** – Meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, e qesim ne votim pikën e pestë te rendit te ditës. Konstatoj se unanimisht kalon për mbledhje te kuvendit. Kalojmë ne pikën e gjashte te rendit te ditës:

**6. Shqyrtimi i vendimit për shpalljen me interes te përgjithshëm publik pjesën e parcelës P – 71510057-01472-3 në zonën kadastrale ne Rahovec.**

**Afrim Oruqi** – Te nderuar anëtar te KPF-së para jush keni materialin propozimin e kryetarit te komunës per shpalljen me interes te përgjithshëm te nje pjese te parcelës që behet fjalë per zonë kadastrale ne Rahovec, ku kemi pasur kërkesë prej banoreve te komunitetit ne atë lagje, që ju e keni materialin se bashku me certifikatën e pronës kopjen e planit skicën e terrenit propozimin edhe ortofotot. Qëllimi i shpalljes që behet

fjalë për parcelën me nr.72/3 ne zonën kadastrale ne Rahovec, ku sipërfaqja e përgjithshme e kësaj parcele është shume me madhe se sa që kërkojmë ne me shpall me interes te përgjithshëm. Pra sipërfaqja totale është 13,60m<sup>2</sup> dhe ne po kërkojmë me shpall me interes te përgjithshëm pjesë te kësaj sipërfaqe 60m<sup>2</sup>. Kjo parcelë është vendin e quajtur Padi e evidentuar sipas certifikatës se pronësisë se Mehdi Baki Shehu. Qëllimi i shpalljes se interesit te përgjithshëm te kësaj pjese te parcelës është zgjerimi i rrugës, pasi ne atë zonë kadastrale është rruga ekzistuese kadastrale e cila nuk i plotëson kushtet që komuniteti lagjja me kalua ne atë rrugë. Kështu që kemi biseduar me banoret e lagjes që po ashtu kemi edhe kërkesën me shkrim prej banoreve te lagjes te protokolluar dhe te dorëzuar pran drejtorisë për gjeodezi dhe kadastër që kanë kërkuar nga ne që me zgjerua dhe e vëtmja mundësi për me zgjerua ketë rruge është se kemi rae ne kontakt me pronarin dhe pas shpalljes me interes te përgjithshëm te kësaj parcele sipas ligjit dhe pas aprovimit te ligjshmërisë ne MAPL me miratimin e juaj ne një seancë tjeter do te bëjmë këmbimin e kësaj parcele. Pra qëllimi është interes i përgjithshëm zgjerimi i rrugës ne atë lokalitet. Në seancën tjeter krejt këto materiale që i keni përparrë do ti keni të prezantuara me ngjyre edhe ne projektor. Ftojë anëtaret e KPF-së që te votojnë propozimin e kryetarit te komunës që te kaloj ne kuvend per shpallje me interes te përgjithshëm.

## 7. Shqyrtimi i propozim vendimit për shpalljen me interes te përgjithshëm publik P-71510057-01997-10 dhe P-71510057-01997-11 në zonën kadastrale ne Rahovec.

**Afrim Oruqi** – Të nderuar anëtar te KPF-së, para jush keni propozimin e kryetarit te komunës sipas ligjeve ne fuqi për shpallje me interes te përgjithshëm publik për dy parcela. Bëhet fjalë për parcelën 01997-10 dhe 01997-11. Këto parcella janë në zonë kadastrale ne Rahovec, konkretisht mbi institutin e Bujqësisë, ku aktualisht këto parcella janë pronë shtetërore te Kosovës por nen menaxhimin te agjencionit kosovar te privatizimit. Sipërfaqja e këtyre parcellave sipas numrave është P-01997-10 është 16,6m<sup>2</sup> kurse P-01997-11 është 9 ari. Në si komunë kemi fitua një projekt për ndërtimin çerdhes ne qytet ku lokacion te përshtatshëm përveç këtij lokacioni dhe disa lokacioneve tjera nuk kemi. Kështu që obligohemi sipas ligjit pasi që kjo është procedurë ku fillimisht duhet te shpallet interes i përgjithshëm e pastaj me negociua me AKP-në me i shpronësua ose me i këmbye, që me i kthyje pronat dhe me i bo pronar komunën e Rahovecit. Sa i përket pikave ftoj anëtaret e KPF-së dhe te kuvendit që për pikat e rendit te ditës aty ku kanë nevojë per informata shtesë munden me ju drejtua drejtorive, përndryshe ne pranojmë çdo muaj kërkesa prej qytetareve me marr prona me qera dhe unë obligohem që sipas ligjit me ju përgjigj atyre brenda 30 ditëve dhe ne nuk kemi mundur me marr vendime ne kuvend që me i dhanë këto prona me qera 4 muaj para zgjedhjeve lokale dhe kemi me dhjetëra këto kërkesa. Kështu që unë si drejtor i gjeodezisë kadastrës dhe pronës çdo seancë do te ju sjelli minimum ka 5-6 pika dhe nëse ka nevoje do te qëndrojmë deri ne orët e vona, pasi unë duhet qytetareve me ju dhanë përgjigje me shkrim për kërkeshat e tyre, kështu që ju vendoseni a doni me kalua apo jo pasi është e drejtë e juaja pra e anëtareve te kuvendit me vendos që a dëshiron me dhanë me qera apo jo, pasi është obligim i jemi si drejtor që kur e pranoj kërkeshën që me prezentue ne kuvend pastaj ju vendoseni pasi është e drejta e juaj. Mirëpo unë duhet te ju përgjigjem me shkrim qytetareve për prezantimin dhe kanë kërkeshë kuvendarët pasi dojnë me pushua pak dhe vazhdojmë ne muajt e tjerë.

**Bejtullah Deliu** – Unë mendoj që edhe ne jemi këtu pikërisht për këto pika dhe sigurisht për interesin e qytetareve dhe sigurisht se do t'i analizojmë dhe ajo çka është në interesin publik normal që jemi pro punëve te mira dhe nuk kishim asnje vërejtje të vetme rreth këtyre pikave.

**Kryesuesi** – Meqë nuk kemi të tjerë të lajmëruar rreth kësaj, atëherë pikën e 6-të dhe te 7-të e qesim ne votim. Konstatoj se me shumicë votash kalojnë për kuvend edhe pika 6-të dhe 7-të. Kalojmë ne pikën e tetë te rendit te ditës:

## 8. Shqyrtimi i vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2021 ne vitin 2022.

**Afrim Limani** – Pëershëndetje për ju kryesues, nënkyetar dhe ju anëtar te KPF-së. Bartja e mjeteve nga viti 2021 ne vitin 2022 është i përcaktuar qartë me ligjin e financave publike dhe përgjegjësive konkretisht neni 9 e përcaktion ne mënyrë te qartë, i cili thotë se pas barazimit apo dorëzimit te pasqyrave financiare dhe alokimit te buxhetit te ri për vitin 2022. Si proces bartja e mjeteve duhet te bartet nga viti 2021 ne vitin 2022. Komuna e Rahovecit brenda vitit 2021 ka një total te shumes se mjeteve për bartje me vlerë prej 592,276 euro që do te thotë një tejkalim te te hyrave e kemi ne shumen prej 436,779 euro ndërsa pjesën tjeter prej 154,000 eurove është pjesë e mbetur e te hyrave vetanake te buxhetit te vitit 2021 që do te thotë se edhe kjo

shume është bartur ne vitin 2022. Pas një analize te mirë nga drejtoria e Financave dhe Buxhet, te gjitha projekteve kapitale dhe obligimeve te bartura kuptohet edhe ne koordinim me drejtoret e drejtorive ne kemi propozuar këtë bartje te mjeteve që te bëhet ne kuadër te këtyre projekteve. Prioritet ju kemi dhënë disa borgjeve te vjetra që për një arsyesh ose tjetër kanë ngelë te pa paguara pastaj prioritet ju kemi dhënë edhe disa projekteve te cilat kanë kaluar ne rezervë që dy vite që me udhëzimin e ri 06/2019 çdo projekt kapital duhet te i nënshtrohet disa kritereve, kështu që komunës se Rahovecit janë gjithsej 9 projekte që nuk kanë kaluar ne baz te kritereve atëherë ekziston mundësia që këto projekte te mos kalojnë fare, kështu që prioritet ju kemi dhënë që ti mbulojmë edhe disa fatura apo obligime financiare te cilat aktualisht i kemi ne drejtorinë e financave. Gjithashtu prioritet ju kemi dhënë edhe projekteve kapitale te reja te cilat që janë te planifikuara por te pa buxhetuara dhe këto projekte janë ndërtimi i shkollës filllore te mesme te ulët Bekim Sykla ne Rahovec që i kemi ndaje 60,000 euro që me fillua punën pastaj ndërtimi i shkollës filllore ne Xerxë 60,000 euro, ndërtimi i aneksit te shkollës filllore te ulët 4 Dëshmorët ne Ratkoc, ndërtimi muzeut për shkrimitarët dhe atdhetarët Sylejman Krasniqi. Te gjitha këto projekte kanë qenë te planifikuara ne listën e projekteve kapitale por te pa buxhetuara dhe tash konsiderojmë se duhet me bo një përpjesëtim te mjeteve. Projekt tjetër te ri e kemi ndërtimi i shtëpisë se përbashkët per banim që është faza përfundimtare kjo dhe operatori deri me tanë ka hezitue dhe nuk i ka krye punët dhe i ka kalua te gjitha afatet ligjore dhe mbi këtë vlerë 50,000 e mbyllim këtë projekt dhe duhet me hap procedurë te re për lidhje te kontratës. Gjithashtu si projekt tjetër te ri kemi ndërtimi i qendrës per magazinimin e prodhimeve bujqësore ku kemi ndaje një shume simbolike te mjeteve sa me i iniciua procedurat për lidhje te kontratës dhe krejt ne fund e kemi ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore ne vlerë prej 50,000 eurove ku kemi obligime financiare ne kuadër te kësaj kontrate. Kërkoi nga ju që te votohet kjo pikë dhe te kaloj per ne seancën e kuvendit pasi që këto mjete mund te mbesin ne pauze.

**Bejtullah Deliu** - I nderuar drejtor, në këto pika që bartja e mjeteve është në interesin e përgjithshëm që mos të mbесin të pashfrytëzuara por ndoshta do të ishte mirë që te kjo pjesa e magazinimit të ceket me saktësish apo e keni lenë në seancë por do të ishte mirë që edhe këtu të kemi të precizuar rreth mjeteve që të dihen me saktë si për rrugë e sidomos kjo pikë për magazinimin e prodhimeve bujqësore se ku është apo si është planifikuar dhe ne sa fazë që te jemi më të orientuar më shumë se si do të merr epilog kjo pikë.

**Besa BYTYQI** – Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin Afrim Limani për sjelljen dhe shpjegimet detajuara dhe konsideroj që te gjitha këto projekte janë në të mirë të jetës së qytetarëve gjithashtu shumë të nevojshme për të gjithë qytetaret dhe sidomos te kategoria e arsimit kur e dimë se këto shkolla kanë nevojë emergjente për tu ndërtuar. Kështu që stoq te gjithë kolegët që të votojmë këtë pikë që të kaloj në seancë të kuvendit.

**Rumir Zhuniqi** – Faleminderit kryesues, unë kam një pyetje tek programi për kulturë, ku shkruan ndërtimi i muzeut në Krushë të Madhe dhe kllapa shkruan për Sulejman Krasniqin që është nga Hoça e Vogël, pasi kemi edhe muze në Krushë të Madhe mirëpo tash nuk e dija saktë se për cilin projekt se për çka bëhet fjalë.

**Kryesuesi** – Para se me fillue me drejtorin, në cilësinë e anëtarit të KPF-së, te mungesa e kodeve buxhetore te shkolla “Bekim Sylka” dhe “Hamëz Thaçi”, po besoj që kjo është edhe anomali e buxhetit që nuk specifikon, gjithashtu edhe te rrugët që po ndërtohen si p.sh. ndërtimi i rrugës në Drenoc mirëpo nuk janë te specifikuara se cilat rrugë dhe gjithashtu anëtarëve të kuvendit komunal në materialin që do të ju dërgohet për seancën e rregullt kisha këruar që me ju vendos edhe këto kode buxhetore bashkë me materialin që me pas mundësi me ditë që këto mjete po bartën edhe pse ata kanë çasje ne buxhet por besoj që do te ishe me ne rregull.

**Afrim Limani** – Faleminderit për pyetjet z. Deliu, ne cilësinë e drejtorit për buxhet dhe financa mundem me ju dhanë disa informata ndoshta jo ne detaje që juve do te interesonit mirëpo ndërtimi i qendrës për magazinimin e produkteve bujqësore ka dal si rezultat i kërkesës se vazhdueshme I qytetarëve dhe është një premtim I kryetarit që e ka dhëna gjate fushatës, por për informata me te gjeresishme do te japim edhe ne mbledhje te kuvendit pasi do te jetë I pranishëm edhe drejtori I bujqësisë, por sigurisht se do te ndërtohet dikon ne periferi te qytetit. Pastaj ne pyetje e parashtruar nga Rumir Zhuniqi, ne momentin kur e kemi bërë hartimin për projekte kapitale ne shtator kur e kemi votue buxhetin për vitin 2022, pikërisht ndërtimi i muzeut për shkrimitarët dhe atdhetarët Sylejman Krasniqi kemi marr direktiva nga departamenti i ministrisë

se financave se ekziston rreziku që ky projekt do te futet ne rezerva dhe atëherë sugjerimi i atyre dhe i falënderoj shume, ndërtimi i këtij projekti le te futet ne kuadër te muzeut sepse është analog i ngjashëm me te dhe mundësia është zero që ky projekt me kalua ne rezerva. Kështu që ky projekt hinë ne kudër te këtij projekti edhe ndahet si lote e veçante ndërtimi i tij. Po ashtu edhe ne pyetjet e parashtruara nga kryesuesi, ne i kemi edhe kodet e këtyre projekteve si ndërtimi i shkollave pasi janë te planifikuara ne buxhet kurse per rrugët i kemi disa shpenzime pasi kemi planifikuar bartjen e mjeteve ne kuadër te ish projekteve te vjetra që për një arsy apo tjetër kanë ngelur pa u paguar deri me tash. Kjo është ndërtimi I kompleksit përkujtimor Dëshmoret e Kombit 3400 euro, pasi ky projekt e dimë te gjithë ku është por për 4 vite ne kuadër te këtij projekti dhe që nga viti 2018 kur kemi marr pushtetin kemi filluar me lëvizë ne këtë drejtim pra operatori i ka krye punët e kemi bëre pagesën dhe kjo shume ka ngelur pasi nuk kemi pasur informata dhe mesa e di unë gjate vitit 2021 operatori e ka ofrua faturën për pagës edhe tash qëllimi i jonë pasi ky borgj është nga viti 2012-2014 dhe gjithashtu është edhe me ligj i përcaktuar se këto borgje te vjetra ne dojmë me i shlye që mos te figurojnë edhe deri ne vitin 2017 edhe me këtë bartje nuk kemi më borgje, që eventualisht ndonjë borgj mund te fillon nga viti 2018 e tutje. Gjithashtu krejt këto projekte te tjera kanë te njëjtën përbajtje si psh te ndërtimi i shkollës filllore Heronjtë e Kosovës ka ngelur pa u mbyllur kontrata edhe 16,000 euro pastaj ndërtimi i çerdhes ne Xerxe edhe këtu e mbyllim kontratën me 16,000, furnizim me gypa Pvc edhe ky projekt ka kalua ne kuadër te rezervave dhe që është rreziku që mos me mujt me kalua ky projekt atëherë ne operatorin po i mbësim borgj dhe kemi ndaje një sasi te mjeteve që me i pagua faturat dhe obligimet që i kemi.

**Përparim Krasniqi** – Faleminderit kryesues, do te isha përgjigj ne pyetje që u parashtrua për çështjen e rrugëve. Nuk specifikohet ne vendime se cilat rrugë pasi është material vuluminoz dhe është kontratë shume e madhe që me cekë se cilat rrugë pasi që ka kontrata që i ka 50 rruge dhe është e paimagjinueshme me gjithë atë material. Por që tani ju shpjegoj e këtij projekti, pasi projekti është i vitit 2017 dhe ka përfundua ne vitin 2020 dhe ne vitin 2019 paraprak nuk kanë planifikuar mjete sa duhet dhe ka pasur një ngecje te operatorit ekonomik dhe jemi detyrua që ne vitin 2020 ta përfundojmë projektin dhe nuk ka pasur mjete te mjaftueshme dhe jemi detyrua tash me planifikua mbylljen e kontratës, që është një projekt edhe me rekomandime te auditorit te jashtëm se nuk guxon me i pagua borxhet e vjetra pa i përfundua kontratat e vjetra dhe me fillua te rejat.

**Bejtullah Deliu** – i nderuar drejtor, sa e shoh që janë pikat e rendit te ditës që duhet me kalua si ndërtimi i rrugëve, ndërtimi i shkollave kurse ne sqarim po jepet që kontratat janë te përfunduara, që unë mendoj se do te ishte mirë me cekë se janë te përfunduara apo bartje borxheve për pagesë për përfundim të projekteve, pasi këtu shkruan diçka dhe shpjegohet diçka tjetër atëherë është në kontradiktë dokumenti me shpjegimin. Gjithashtu edhe te çështja e rrugëve që thuani se janë shume projekte, edhe unë pajtohem me kryesuesin se munden me qenë shumë projekte por do të ishte mirë që të behet specifike se cila rrugë ka me u ndërtua edhe deri ku do te ndërtohet pa marr parasysh se ne cilin vendbanim do te ndërtohet ajo rrugë, pasi edhe aty ekzistojnë emërtime të rrugëve por le te dihet fillimi dhe mbarimi i cilës rrugë bëhet.

**Kryesuesi** – Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, e qesim ne votim pikën e tetë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht kalon për kuvend pika e tetë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e nëntë te rendit te ditës:

#### **9. Shqyrimi i propozim vendimit për mbulimin e shpenzimeve te varrimit për vitin 2022.**

**Saranda Sallteku** – Me propozimin e kryetarit te komunës, i propozojmë Komitetit për Politikë dhe Financa që mbulimet e shpenzimit te varrimit për vitin 2022 ne Komunën e Rahovecit te lidhë marrëveshje me te gjitha bashkësítë fetare që veprojnë ne territorin e komunës se Rahovecit. Pakoja e shërbimeve primare do te definohet me marrëveshje te re dhe ajo nuk mund te ketë kosto me te lartë 200 euro për një rast ndërsa për shpenzimet e tjera që nuk janë pjesë e marrëveshjes qytetaret do te sigurojnë ato personalisht.

**Kryesuesi** – Faleminderit, atëherë meqë nuk tjerë te lajmëruar, e qesim ne votim. Konstatoj se unanimisht kalon për kuvend pika e nëntë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e dhjetë te rendit te ditës:

## **10. Shqyrtimi i propozim vendimit për subvencionimin e lindjeve për gratë- nënët banore te Komunës se Rahovecit për vitin 2022.**

**Saranda Sallteku** – Me propozimin e kryetarit te Komunës, i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa që te merr vendim për gratë që lindin brenda komunës se Rahovecit ne qendrën kryesore te Mjekësisë Familjare „Fahredin Hoti,, ne Rahovec, me shumen prej 300 euro. Subvencionimi sipas pikës 1 te këtij propozimi do te behet nga data 01.01.2022 deri 31.12. 2022.

**Melinda Iska** – Përvendetje kryesues, nënkyetar, drejtore drejtive, anëtar te KPF-së dhe gjithë ju te pranishëm. Unë dua te di se cili është qëllimi që po e ndryshoni vendimin e asamblesë komunale që subvencionon prej 200 euro për secilën grua që ka lind pa marr parasysh se ne cilin vend ka lind ajo grua, vetëm dua te di qëllimin se pse po e ndryshoni ketë vendim.

**Fatmir Iska** – Faleminderit për pyetjen, atëherë qëllimi është subvencionimi më i madh dhe me i stimulua nënët lehon që me lind ne QKMF. Vendimi i mëparshëm ka qenë ne mars apo prill te vitit te kaluar atëherë kemi dhënë propozim 200 euro për ata që lindin ne QKMF dhe ata që lindin diku tjetër te subvencionohen me 100 euro. Ideja është me i subvencionua lindjet për arsyen se ka rënien brenda vitit 2021 që kishim rrith 36 lindje ne QKMF dhe po besoj që edhe pse prapë është stimulimi i vogël por duhet që te stimulohen që te lindin ne QKMF dhe gjithnjë kjo me idenë që vitet vijuese te rritet kjo shume dhe te shkoj deri ne 500 euro për një lindje. Edhe pse nuk janë mjete te mjaftueshme por sidoqoftë kjo është një shume që mundet me përballua kodi i subvencioneve nga buxheti komunal për vitin 2022.

**Melinda Iska** – A keni menduar se ka ndodhë me gruan që shkon aty me lind kurse gjinekologu i referon me shkue ne spital.

**Fatmir Iska** – Sigurisht që i kemi menduar edhe këto çështje, por nëse është ne pyetje jeta e njeriut dhe paraqiten vështirësi pavarësisht vullnetit që dëshiron dikush me lind atëherë me e rendësishme është jeta e njeriut apo siguria e jetës qoftë e fëmiut apo e nënës se sa vlera që mund te parashikohet ne këtë vendim për stimulim.

**Bejtullah Deliu** - Ashtu siç foli Melinda paraprakisht, mos është rastësisht cenimi i të drejtave të banorëve që nëse ka dikush komplikime edhe gjata shtatzënës dhe shkon diku tjetër pa u paraqit ne QKMF dhe ndërkohë është banor i komunës se Rahovecit dhe jep taksë dhe kontribut dhe në momentin që komuna duhet me dhanë diçka për qytetarin atëherë heziton të bëj, pa marr parasysh që vlerën e keni rritur këtu por nuk do te thotë që kjo vlerë mos me mundur me pas një zgjidhje edhe për raste te tjera që mos te cenohet asnjë grua e komunës tone. Kështu që kudo që lind do të ishte mirë që kjo pikë mos me ndryshua dhe kërkoj edhe nga ju drejtoreshë që t'i jepni përkrahje kësaj, kurse sa i përket lindjeve ne QKMF do të ishte mirë të bëhet sensibilizim i qytetareve që një iniciative nga kjo drejtori përkatëse të merret në vazhdimësi dhe të sensibilizohen gratë e komunës tonë që të lindin dhe gjithashtu të promovohet puna e mirë e punëtorëve por unë mendoj se ekziston mundësia tjetër për me rrit numrin e lindjeve ne QKMF por jo në këtë formë të cenohet e drejta për këtë subvencionim nga komuna.

**Fatmir Iska** – E drejta ne subvencionim nuk përcaktohet ne bazë te vendqëndrimi përcaktohet ne bazë te vendbanimit, gjithashtu edhe me kushtetute është e garantuar jeta integriteti i njeriut dhe ne këtë rast ne mund te mos pajtohem me shumen e subvencionimit që ndoshta mund te jetë e vogël por duke marr për bazë që jeta është shume me e madhe se me vlerën që mundet me u subvencionua qoftë kjo apo ndoshta edhe me shume ne te ardhmen atëherë ajo është recetë apo udhëzim i mjekut pasi e përcakton se a ka veshtirsi apo nuk ka. Kështu që ne momentin që lind një fëmijë jashtë komunës se Rahovecit qoftë ne privat apo publik ne Republikën e Kosovës evidentohet vendlindja dhe jo vendqëndrimi dhe mbi bazën e asaj është ky vendim, kështu që ne do te diskutojmë edhe ne seancën e kuvendit dhe do te shohim dhe do te marrim edhe propozimet tjera por mundësia buxhetore është kjo. Por nëse e rrisim ne këtë rast shumen kushtimisht 1000 euro atëherë ne duk do te kemi mundësi me ndaje mjete për bursa për studentë apo eventualisht vendimin që e paguat me herët për shërbimet e varrimit ti mundesh me pas si vendim por mjete për ekzekutim për bashkësinë islame që kemi si komunë marrëveshje nuk mundesh me i pagua për arsyen se kodet janë te përcaktuara dhe secili kod e ka buxhetin pasi nuk mundesh me marr prej një kodin tjetër.

**Bejtullah Deliu** – Ketë shpjegim që po e jepni se si barten mjete dhe si sigurohen është punë e ekzekutivit se si do ta bëj këtë pasi nuk e kam hallin e ekzekutivit se si do ta organizoj këtë por e kam hallin e qytetarëve që neglizohet apo cenohet e drejta e secilës femër të subvencionohet në mënyrë të barabartë pasi mund të ndodh që dy motrat që janë të së njëjtës shpi dhe njëra lind në QKMF dhe tjetra për arsyet e ndryshme lind jashtë territorit të komunës së Rahovecit, kështu që ju po i cenoni te drejtat e një familje. Pra, kodet buxhetore dhe ndarja e mjeteve është dashur te mendoni ju se si do te organizoni këtë dhe do te ishte mirë që kur të bëni një planifikim të bëhet i tërësishtëm dhe ne mënyrë të rregullt që të mos cenohet e drejta e qytetarëve të Komunës se Rahovecit.

**Fatmir Iska** – Këtu aspak nuk ka të bëj me cenim te drejtave pasi edhe ne vitin 2021 siç e përmenda me herët e cekem se janë 36 lindje që realisht ka rënë numri i lindjeve ndjeshëm, kështu që ideja është stimulimi i lindjeve ne QKMF. Kurse sa i përket mjeteve apo kodeve ju mund ta shihni ne shtator pasi secili kod i ka mjetet e planifikuara dhe këto janë direktiva te ministrisë se Financave dhe jo te Komunës pasi ne kemi dëshirë me pas subvencione edhe 1 milion euro mirëpo realiteti është se kemi vetëm 360,000 euro.

**Bejtullah Deliu** – Dua te ndërlidhem tek pjesa që thatë se ka pasur vetëm 36 lindje për vitin 2021, por ekzistojnë mënyra të ndryshme që te sensibilizohen gratë tona që te kenë besim ne QKMF apo institucionet tona. Pra, duhet te gjinden mënyra të ndryshme apo u deshtë me herët të bëhet që mos me ardh deri te ky keqinterpretim dhe faktikisht është cenim nëse nuk i lejon te drejtat e barabarta për te gjitha gratë lehon. Kështu që nuk mendoj se kjo pikë duhet te kaloj ne seancë ne këtë formë ashtu siç është, mendoj se duhet te ndryshohet kjo që te jetë sa më e kompletuar dhe te jetë e zbatueshme për të gjitha gratë lehon ne mënyrë te barabartë pa marrë parasysh se ku lindin.

**Fatmir Iska** – Komiteti për Politikë dhe Financa si komitet obligativ konsiderohet filtër i propozimeve dhe pastaj të gjitha ato propozime vendimin e formës së prerë e jep kuvendi komunal, kështu që ne kuvend ne do te kemi mundësi me i diskutua prape por propozimi jonë dhe arsyetimi jonë është ky i ekzekutivit. Ne kemi dëshirë me i rrit subvencionet edhe për bursa edhe për shërbime te varrimit por mundësit buxhetore ne kodin për subvencione janë te precizuara saktë prej Ministrisë se Financave.

**Rumir Zhuniqi** – Unë kisha kërkuar prej drejtoreshës që ne seancën e kuvendit ku e diskutojmë me gjerësisht këtë pikë që me sjellë informata se sa lindje bëhen brenda vitit ne QKMF dhe sa lindje bëhen ne përgjithësi prej banoreve te komunës se Rahovecit, që ta kemi një pasqyrë të qartë se sa është impakti financiar nëse i subvencionojmë vetëm lindjet në QKMF dhe sa është impakti financiar nëse i subvencionojmë krejt nënët që janë të regjistruara si banore të komunës së Rahovecit dhe pasi të kemi këtë pasqyrë mundemi me ditë.

**Kryesuesi** – Gjithashtu edhe unë kam një koment rrith kësaj pasi edhe unë jam kundër kësaj pasi nuk mundesh me nxitë gratë me lind me një qendër që ndoshta edhe nuk i ka kushtet esenciale për një lindje normale. Unë po e marr një shembull shumë konkret, nëse një grua shtrohet për lindje ne QKMF edhe po komplikohet gjendja e saj para lindjes dhe në bazë te udhëzimit ajo po shkon në spitalin regional ne Gjakovë me lind atëherë kësaj nënë lehonë po i mohohet me marr këtë subvencionim për lindje. Kështu që kjo është shume e padrejtë dhe gjithashtu cenim i një te drejte për me fitua dhe unë po besoj që ndoshta edhe shuma duhet te jetë me e vogël por që duhet t'i përfshijë te gjitha nënët dhe gratë që janë banore te Komunës se Rahovecit. Po ashtu kam një vërejtje rrith kësaj, që përbajtja e propozimit edhe e pikës se rendit te ditës nuk është e njëjtë, pasi pika e rendit te ditës shume mirë dhe qartë e thotë që shqyrtimi i propozim vendimit për subvencionimin e lindjeve për gratë –nënët banore te Komunës se Rahovecit kurse përbajtja është tjetër dhe ne këtë aspekt për me nxitë lindjen ne QKMF kryesore në Rahovec atëherë mundemi me bo një shume me te madhe si p.sh. 200 për lindje për çdo banor te komunës se Rahovecit atëherë duhet me bo 300 euro për lindjet që bëhen ne QKMF në Rahovec. Kështu që unë nuk po e shoh te arsyeshme që ky propozim me kalua ne seancën e rregullt por shpresoj që duhet me u ndryshua.

**Besa Bytyqi** – Unë e kam një pyetje për te gjithë ata që e dinë sektorin e shëndetësisë pak me mirë se unë, nëse nga 36 lindje që janë bërë ne komunën e Rahovecit pikërisht në repartin e lindjeve dhe bie në 2 numri i lindjeve atëherë çka do të ndodhe me atë repart, a duhet me i vendos çelësin apo duhet me mendua ne që me avancue këtë sektor që me pas edhe mjete me të mira, doktor edhe motra medicinale apo duam me shkuan vetëm duke e ulur numrin duke menduar me i subvencionua te gjitha. Unë jam për subvencionimin e të gjitha

nënave dhe lindjeve por mendoj se duhet me i pas parasysh se ne dëshirojmë të ngrisim edhe standardin e jetesës sonë këtu por edhe në QKMF t'i ngrisim kushtet dhe t'i bëjmë me të mira. Do të ishte mirë të marrë një përgjigje rreth kësaj.

**Bejtullah Deliu** – Nuk e di ma mirë se parafolësja për shëndetësi, por, vetë faktin se si e dha arsyetimin prej 36 ne 2, nuk është qëllimi këtu tash t'i ngushtojmë që të mos kaloj kjo pikë, por, qëllimi është të përfitoj qytetari i komunës tonë edhe kjo formë qysh po kërkojnë këta me kalua, u dashtë më herët me mendua se si duhet të ngritet vetëdija e qytetarëve për me lind fëmijë, e jo në këtë moment dhe vetëm te stimulimi 100 euro me tepër për me u rrit atëherë po e votojmë por si te sigurohemi që me 100 euro qenka arsy e vetme edhe tash do të ketë rritje edhe të lindjeve në QKMF. Gjithashtu edhe nënkyetari që e tha që ne bazohemi të vendi i lindjes, a ka mundësi me na tregua dikush nga ekzekutivi sesa lindje i kemi nga komuna e Malishevës ne QKMF në Rahovec dhe a kanë te drejtë ata me aplikue ne komunën tonë për subvencionim apo si qëndron puna.

**Fatmir Iska** – Pikërisht është kjo pikë që shqyrtimi i propozim vendimit për subvencionimin e lindjeve për gratë-nënët banore te Komunës se Rahovecit, kështu që kjo është shume e precizuar dhe e qartë pika e rendit te ditës vetëm për banoret e Komunës se Rahovecit, kështu që çka do te ndodh për lindjet që ndodhin ne komuna tjera pasi te njejtin vendim e kanë edhe komuna tjera atëherë shtrohet pyetja se a marrin kompensim ne komuna tjera këtë subvencionim edhe prapë me kerkua subvencionim edhe ne komunën tonë. Pra kjo është e precizuar qartë te komunës tonë kuptohet për nënët lehon. Gjithsej 343 lindje që kanë ndodhur gjat vitit 2021, prej tyre 36 janë ne QKMF dhe vlera totale është 69,400 euro. Pastaj nuk kemi thënë që arsyaja e vetme e subvencionimit apo e rritjes se numrit te lindjeve ne QKMF është kjo, por është një form e stimulimit, p.sh. një formë e krahasimit kur janë ndajet mjetet kur është marr vendim për subvencionimin e shtesave te fëmijëve që është 10 euro për një fëmijë, ne bazë te kategorive te caktuara dhe po e bëjmë se sa janë 10 euro për një fëmijë si shtesë, që realisht si ide shume e mirë me mundësi te rritjes për me vonë Kështu që e përmenda edhe ne fillim që 300 euro i kemi tani mirëpo me mundësi te rritjes ne vitet vijuese, sigurisht se do te këtë gjithmonë rritje mbi bazën e rritjes se buxhetit apo edhe direktivave te përcaktuara prej ministrisë se financave te ndryshimit te kodeve apo edhe rritjes se vlerave njëra me tjetrën.

**Bejtullah Deliu** – I nderuari nënkyetar, jemi në kontradikte me disa fakte, kështu që për këtë pikë te rendit të ditës kisha propozua që drejtoresha te vij edhe me elaborue me saktësisht këtë pikë, pasi nuk mendoj që është ne rregull që se paku kjo pikë te kaloj për ne seancën e ardhshme pasi për këtë mbledhje nuk mendoj që do te këtë mbështeten e shumicës.

**Rumir Zhuniqi** – I nderuar kryesues, unë mendoj se roli i KPF-së është me kerkua informata shtesë ndërsa debati përbajtësor bëhet ne kuvend. Unë po kërkoj që informatat që neve na duhen për mbledhje te kuvendit me i kerkua sot kurse ne mbledhjen e kuvendit dhe pastaj ne kuvend diskutohet dhe vendoset krejt këto pika që i diskutuem. Ne tani e përcaktojmë formën por jo edhe përbajtjen e vendimeve ne KPF, pasi ne jemi një filtri para seancës se kuvendit, pasi nuk e kemi rolin që sa jemi 7 anëtarë me ju cene anëtarëve tjerë te kuvendit, që ndoshta kanë propozime tjera ata edhe me kreative për këtë pikë dhe sigurisht se duhet me ju dhanë mundësinë që me kalua ne kuvend.

**Kryesuesi** – Unë këtë çështje po e shoh pak si me ndryshe sikur ju që përfaqësoni 500 vet brenda ne kuvend dhe ne nuk shkojmë me ju marr mendimin secilit. Kështu që Komiteti për Politikë dhe Financa është i deleguar prej kuvendit te komunës dhe nëse ne e dërgojmë këtë rend te ditës ne kuvend atëherë shumica do te thotë se çfarë keni bërë ne komitet, pasi neve na kanë delegua këtu për me i rregullua këto pika te rendit te ditës dhe debatin tjetër e bëjmë ne seancën e rregullt te kuvendit. Po ashtu kompetencat e KPF-së nuk janë vetëm filtri por ka edhe kompetenca tjera.

**Rumir Zhuniqi** – Roli i anëtarëve te KPF-së është me i kalua pikat edhe kuvendi është ai që i diskuton përbajtjen e vendimeve, kështu KPF-ja kujdeset që rendi i ditës te jetë ashtu siç është i propozua nga ekzekutivi dhe planit të punës se kuvendit. Ne nuk kemi rol që me ju cene që anëtarëve tjerë te kuvendit që mos me pas te drejtë me diskutua, kështu që tash është propozimi dhe atje diskutohet dhe pikërisht aty merret vendimi që me u aprovue dhe mos me u aprovue.

**Kryesuesi** – Unë mendoj se po i keqkupton kompetencat e Komitetit për Politikë dhe Financa, atëherë pse jemi këtu dhe pse atëherë nuk po e thirrim menjëherë seancën e rregullt te kuvendit. mendoj se edhe rregullorja e punës se kuvendit e parasheh shume mirë kompetencat e KPF-së.

**Bejtullah Deliu** – Pikërisht me herët për këto informata e ceka që drejtoresha paraprakisht do te ishte mirë që te vij dhe te jep informata jo vetëm verbale por edhe me shkrim dhe sigurisht pse mos me kalua nëse do te ishte ne interesin e qytetareve pasi nuk jemi kundër mirëpo deri tash nuk gjetëm ndonjë mangësi që te mos kaloj por kur është fjala te kjo pikë është me e ndjeshme dhe sigurisht se na duhen informata pasi nëse jemi filtër para seancës atëherë duhet edhe që ta shtjellojmë me detajisht.

**Besa Bytyqi** – E konsideroj jo te rrugës që me largua pikë te rendit të ditës duke ditur që jemi në muajin shkurt dhe na duhet me marr ky vendim në asamble komunale dhe jo këtu ashtu siç e tha kolegu Rumir, pasi ne asamble jepet drita e gjelbër apo e kuqe. Ne duhet me dërgua me ndryshime apo me propozimin e njëjtë, ndryshohet miratohet apo plotësohet ne asamblenë komunale ku jemi 31 përfaqësues te zgjedhur nga populli dhe nuk guxojmë me lejua që kjo te ndodhë këtu pasi LDK-ja nuk e ka asnë përfaqësues dhe ne nuk mundemi me dit se çka mundet me mendua ai grup opositar. Kështu që unë konsideroj se duhet me u rishikua dhe me u dërgua për asamble komunale patjetër, sigurisht se patjetër për debate kemi kohe edhe një javë që te plotësohet dhe të na vinë te gjitha informacionet e nevojshme, pasi nuk është e drejtë që te hiqet kjo pike e rendit te ditës dhe te mos shkoj ne kuvend duke ja pamundësuar te gjithë anëtarëve tjerë te kuvendit te mos e dinë se çfarë vendimi kemi marr këtu. Kështu që unë mendoj se duhet me kalua patjetër dhe ta diskutojmë me gjerësisht ne kuvend.

**Kryesuesi** – Atëherë propozimi i Bejtullah Deliut është që nënët apo gratë lehona te subvencionohen për çdo lindje ku do që e bëjnë si banore te komunës se Rahovecit, kështu që si i tillë bashke me këtë propozim për kuvend, e qesim ne votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet edhe pika e dhjetë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e njëmbëdhjetë te rendit te ditës:

**11. Shqyrtimi i vendimit për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës ne terren për zgjedhjen e këshillave lokal;**

**12. Shqyrtimi i vendimit për emërimin e komisionit të ankesave për procesin e zgjedhjes së këshillave lokal;**

**Fatmir Iska** – Faleminderit kryesues, tek vendimi i pare për themelimin apo emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës ne terrene për zgjedhjen e këshillave lokale është propozim dhe komisioni përbëhet prej 7 anëtarëve ku 4 janë nga kuvendi, një nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile. Pastaj nga secila lagje apo vendbanim caktohet nga një anëtar i këshillit. Po ashtu po dua me potencue që mandate i kryetareve te fshatrave ka skaduar, pasi me rregulloren e vitit 2014 kanë pasur mandatin 3 vjet ndërsa me udhëzimin administrativ te vitit 2019 dhe rregullores se re 2021 mandati kryetareve te fshatrave është 4 vjet. Rreth detyrave janë te përcaktuara pikat se kush zgjidhet kryesues, cilat janë detyrat informatat para mbajtjes se takimit ne secilin vendbanim d.m.th. janë te precizuara ne vendim, kështu që për me tepër diskutojmë edhe ne kuvend.

**Kryesuesi** – Atëherë meqë nuk kemi te lajmëruar, këto dy pika I qesim ne votim. Konstatoj se kalojnë për kuvend edhe pika 11-të dhe 12-të. Kalojmë ne pikën e trembëdhjetë te rendit te ditës:


**13. Raporti nga Komiteti për Komunitete për vitin 2021.**

**Kryesuesi** – Sa i përket kësaj pike, ish kryesuesi i Komitetit për Komunitete nuk është prezent mirëpo materialin e raportit e keni para vetes dhe mundeni me analizua mirëpo për mbledhje te kuvendit besojmë qe do te jetë prezent ish kryesuesi i Komitetit për Komunitete ku edhe do te bej raportimin e raportit. E qesim ne votim. Konstatoj se unanimisht kalon për kuvend pika e trembëdhjetë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën fundit te rendit te ditës:

**14. Te ndryshme.**

**Kryesuesi** – Sa i takon i kësaj pike, unë do te them sa i përket Rumirit që te mos ti mbetem borxh, që nga pozita e kryesuesit mundohem që të jem i paanshëm dhe i barabartë me çdo anëtar te kuvendit komunal dhe gjithashtu edhe anëtar brenda Komitetit për Politikë dhe Financa. Edhe mua nuk me pëlqejnë animet mirëpo kur për diçka nuk është në rregull atëherë propozimin mundem edhe me dhanë sikur që kam te drejtë vote. Kështu që ne këtë rast edhe unë jam pro propozimit të kuvendarit Bejtullah Deliu edhe pse nuk i takojmë te

njëjtës parti politike por unë po besoj që çdo banore e komunës se Rahovecit që lind pasi ktu mundet me pas edhe arsyet e tjera që mund te këtë sigurim shëndetësor dhe mundet me shkue me lind ne spitalin amerikan. Por ne këtë rast sa i përket subvencionimit komuna nuk duhet me i etiketua njerëzit që lindin ne QKMF apo ne spitale specifike për subvencionimin e atyre lehonave. Kështu ju falënderoj te gjithëve për kontributin tuaj dhe e konstatoj te mbyllur mbledhjen e Komitetit për Politike dhe Financa dhe shihemi ne mbledhjen e radhës.

  
Procesmbajtësi,  
Agim Hoti

